

VENDIM
Nr. 36, datë 24.11.2016

PËR REFUZIMIN E KËRKESËS PËR ANËTARËSIM NË SKEMËN E SIGURIMIT TË DEPOZITAVE TË SHOQËRISË SË KURSIM-KREDITIT “FUSHAS–MUMAJES”

Këshilli Drejtues i Agjencisë së Sigurimit të Depozitave, në mbështetje të nenit 4, shkronja “a”, të nenit 25, të nenit 26, pika 3, të nenit 27, të nenit 34, pika 1, të nenit 52, pika 1, shkronja “p” dhe pika 2, të nenit 53, pika 5, shkronja “d”, të nenit 68, pika 1/2, të ligjit nr. 53/2014, datë 22.5.2014, “Për sigurimin e depozitave”, i ndryshuar, të nenit 35, pika 4, të ligjit nr. 52/2016, datë 19.5.2016, “Për shoqëritë e kursim-kreditit dhe unionet e tyre”, si dhe të nenit 5, nenit 6, pikat 5 dhe pika 8, si dhe të nenit 41, pika 1, shkronja “b”, të udhëzimit nr. 4188, datë 1.9.2016, “Për sigurimin e depozitave në shoqëritë e kursim-kreditit”, pasi u njoh me relacionin e drejtorit të përgjithshëm mbi përmbushjen e kushteve nga shoqëria e kursim-kreditit “Fushas–Mumajes”,

VËREN SE:

1. Periudha tranzitore për dhënien e vërtetimit për plotësimin e kërkesave ligjore dhe nënligjore lidhur me sigurimin e depozitave, si dhe certifikatës së sigurimit të depozitave përfundon në datën 30 nëntor 2016.

2. Shoqëria e kursim-kreditit “Fushas–Mumajes” ka paraqitur kërkesën për anëtarësim në skemën e sigurimit të depozitave dhe në datë 4 korrik 2016, grupi i punës i përbërë nga punonjës të Agjencisë së Sigurimit të Depozitave dhe Bankës së Shqipërisë, kreu verifikimin për plotësimin e kushteve nga kjo shoqëri.

3. Nga verifikimi i përbashkët u konstatua se shoqëria e kursim-kreditit “Fushas–Mumajes”:

a) nuk kishte pajisje informatike dhe mbështetje në sistemin informatik të shoqërisë së kursim-kreditit “Tirona” në të cilin mungonte moduli për llogaritjen e primit, si dhe nuk mundësohej prodhimi i skedarëve për raportim në Agjenci;

b) në të dhënat identifikuese të depozituesve kishte mangësi;

4. Gjendja financiare e shoqërisë së kursim-kreditit “Fushas–Mumajes” ishte e paverifikueshme për shkak të mungesës së dokumenteve mbështetëse.

5. Strukturat drejtuese nuk ishin në përputhje me kërkesat ligjore për sa i përket përbërjes dhe funksionimit.

6. Ambientet e ushtrimit të veprimtarisë nuk ishin të përshtatshme dhe nuk përmbushnin kushtet e sigurisë fizike për zhvillimin e veprimtarive financiare dhe përpunimin e shumave monetare.

7. Në vijim të verifikimit të datës 4 korrik 2016 shoqërisë së kursim-kreditit “Fushas–Mumajes” iu rekomandua:

a) ndërtimi i modulit elektronik për llogaritjen e primit të sigurimit të depozitave;

b) përgatitja e skedarëve me të dhënat mbi depozitat dhe depozituesit për t’u raportuar elektronikisht në Sistemin për Raportim dhe Kompensim;

c) plotësimi dhe saktësimi i të dhënave të depozitave dhe depozituesve;

ç) informimi i strukturave drejtuese dhe punonjësve në lidhje me skemën e sigurimit të depozitave;

d) pasqyrimi real i transaksioneve me depozitat në sistemin elektronik të shoqërisë së kursim-kreditit bazuar në dokumentacionin justifikues;

dh) garantimi i organizimit dhe funksionimit të strukturave drejtuese në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi;

e) përshtatja e zyrave për kryerjen e një aktiviteti financiar në përputhje me aktet rregullative në fuqi;

ë) zgjidhja e mosmarrëveshjeve me Unionin Shqiptar të Shoqërive të Kursim-Kreditit mbi të drejtat detyrimet përkatëse.

8. Afatet për përmbushjen e rekomandimeve u dakordësuan të ndryshme, por për çështjet me prioritet ato ishin menjëherë dhe shtator 2016.

9. Grupi i verifikimit të Agjencisë kreu verifikimin përfundimtar në datën 17 tetor 2016, mbi përmbushjen e rekomandimeve të lëna nga shoqëria e kursim-kreditit “Fushas–Mumajes”. Nga ky verifikim u konstatua se:

- a) nuk ishte implementuar moduli për përlllogaritjen e primit;
- b) sistemi elektronik nuk mundësonte prodhimin e skedarëve për raportim;
- c) ambientet ishin duke u plotësuar në përputhje me kërkesat rregullatore gjatë procesit të verifikimit;
- ç) aktet e brendshme të shoqërisë ishin rishikuar, por nuk përputheshin me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi;
- d) punonjësit nuk kishin njohuri për skemën e sigurimit të depozitave;
- e) shoqëria e kursim-kreditit “Fushas–Mumajes” kishte nënshkruar një deklaratë noteriale me Unionin Shqiptar të Shoqërive të Kursim-Kreditit, për njohjen e detyrimit prej 8 (tetë) milionë lekësh. Kjo shumë që nuk është pasqyruar në bilancin e muajit shtator 2016, do ta bënte kapitalin e shoqërisë së kursim-kreditit negativ.

Bazuar në sa më sipër, Këshilli Drejtues,

VENDOSI:

1. Shoqëria e kursim-kreditit “Fushas–Mumajes” nuk përmbush kushtet për dhënien e vërtetimit për plotësimin e kërkesave ligjore dhe nënligjore lidhur me sigurimin e depozitave, si dhe të certifikatës së sigurimit të depozitave.

2. Refuzimin e kërkesës për anëtarësim në Skemën e Sigurimit të Depozitave të shoqërisë së kursim-kreditit “Fushas–Mumajes”.

3. Të informohet Autoriteti Mbikëqyrës mbi këtë vendim.

Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas publikimit në Fletoren Zyrtare dhe i dërgohet shoqërisë së kursim-kreditit “Fushas–Mumajes” brenda 7 ditëve kalendarike nga miratimi i tij.

KRYETAR
Donald Duraj